

## MENDIM PAKICE

Si anëtare e trupit gjykues nuk pajtohem me përfundimin e arritur nga ana e anëtarëve të tjerë (“shumica”) për subjektin e rivlerësimit, z. Artan Zeneli, për shkaqet dhe arsyet si më poshtë:

**I. Në lidhje me gjetjen mbi kriterin për kontrollin e figurës,** – se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi revokimin e vizës nga Ambasada e SHBA-ve më datë 26.01.2017, në momentin kur ka dorëzuar Deklaratën për Kontrollin e Figurës, sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016 dhe, për pasojë, nuk kalon kriterin për vlerësimin e figurës, – nuk ndaj të njëjtin qëndrim si shumica.

Sipas nenit 34 të ligjit nr. 84/2016: *“Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin e atyre subjekteve që kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës”.*

Ka rezultuar se më datë 16.01.2017, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur pranë Kuvendit shprehjen e interesit për të kandiduar si anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke paraqitur aplikimin dhe dokumentacionin e plotë për vetting. Më datë 27.01.2017, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar pranë DSIK-së Deklaratën për Kontrollin e Figurës. DSIK-ja, në datën 31.10.2017, ka konstatuar në raportin e saj drejtuar Komisionit përshtatshmërinë e vazhdimin të detyrës për subjektin Artan Zeneli. Më datë 08.03.2018, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit i ka kërkuar DSIK-së rishikimin e raportit për kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Artan Zeneli. Më datë 09.03.2018, DSIK-ja, me shkresën me nr. \*\*\* prot., datë 9.3.2018, me qëllim integrimin e informacioneve të ardhura pas afatit ligjor të datës 02.11.2017 të përfundimit të procedurave të kryera nga Grupi i Punës për kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Artan Zeneli, ka dërguar raportin e rishikuar për kontrollin e figurës, ku referon se: *“Në vlerësim të të dhënave të ardhura pas konstatimit fillestar mbi subjektin e rivlerësimit, gjykohet se: referuar parashikimeve të bëra në Aneksin e Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë “Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve”, në nenin DH “Kontrolli i figurës”, pika 4, subjekti i rivlerësimit, Artan N. Zeneli, evidentohet se ka bërë deklaram të pasaktë në plotësimin e Deklaratës për Kontrollin e Figurës, konkretisht në germën “g” të pjesës nr. 5 “Të dhëna për sigurinë””.*

Në bazë të nenit DH të Aneksit të Kushtetutës, subjektet e rivlerësimit kanë detyrimin të plotësojnë dhe t’i dorëzojnë Komisionit një deklaratë të detajuar për figurën e tyre, e cila mbulon periudhën nga data 1 janar 2012 deri në ditën e deklarami, sipas ligjit. Sipas pikës 3 të këtij neni, për subjektet e rivlerësimit që kanë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.

Nëse subjekti i rivlerësimit nuk e dorëzon në kohë deklaratën për figurën sipas ligjit, ai shkarkohet nga detyra.

Nëse subjekti i rivlerësimit përpiket të bëjë deklarime të pasakta ose të fshehtë kontaktet me persona të përfshirë në krimin e organizuar, zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën. Ndërsa, sipas nenit 35, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, është parashikuar se subjekti i rivlerësimit plotëson deklaratën për kontrollin e figurës sipas shtojcës 3 brenda 30 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të tij dhe e dërgon atë pranë Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.

Në vijim të procesit të verifikimit të figurës, me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe garantimin e të drejtave të subjektit të rivlerësimit, për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit DH të Kushtetutës, si dhe referuar Vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, shumica **nuk** ka kryer një hetim të thelluar dhe të plotë për verifikimin e

rrethanave që merren parasysh në konstatim, si dhe rrethanave lehtësuese, të rrjedhura nga informacioni që kishte marrë Grupi i Punës dhe kishin çuar në konstatimin e papërshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës, si dhe vërtetësisë së ngjarjes konkrete, me qëllim gjetjen e provave, për realizimin e një procesi të rregullt ligjor.

Në rastin konkret, duhej të merrej në shqyrtim çështja nga ana e shumicës nëse subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarime të pasakta ose të pavërteta në lidhje me plotësimin e Deklaratës për Kontrollin e Figurës, konkretisht në germën “g” të pjesës nr. 5 “Të dhëna për sigurinë” dhe nëse ky deklarim ndikon dhe në ç’mënyrë në lidhje me objektin. Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin e atyre subjekteve që kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Gjithë procesi duhet të zhvillohet bazuar në prova të sakta, të administruara dhe shqyrtuara në mënyrë objektive. Neni 38 “Standardet e kontrollit të figurës”, pika 3 e tij, parashikon se: *“Kontrolli i figurës përfshin vlerësimin e provave dhe informacioneve që lidhen me rrethanat që merren parasysh në konstatimet, sipas parashikimeve të pikave 4 dhe 6 të këtij neni, dhe rrethanat lehtësuese, sipas parashikimeve të pikave 5 dhe 7 të këtij neni. Vlerësimi duhet të përmbajë rrethanat që merren parasysh në konstatim, si dhe rrethanat lehtësuese të këtij konstatimi. Nëse vlerësimi nuk përmban elementet e parashikuara në këtë paragraf, konsiderohet i paplotë.”*

Rrethanat ku duhet të bazohet vlerësimi sa i përket kontrollit të figurës përcaktohen në paragrafin 4 të nenit 38, të ndara në 5 kategori: a) subjekti i rivlerësimit është fotografuar, ose kur një dëshmitar përshkruan një takim me një person të përfshirë në krimin e organizuar; b) subjekti i rivlerësimit ose personi i lidhur me të ka pasur një komunikim jorastësor me një person të përfshirë në krimin e organizuar; c) subjekti i rivlerësimit ose një person i lidhur me të ka shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar; ç) subjekti i rivlerësimit ka lidhje të ngushta me një person të përfshirë në krimin e organizuar; d) subjekti i rivlerësimit merr pjesë ose është i pranishëm në takime me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar. Anëtarësia e dyshuar e personit në krimin e organizuar duhet të jetë e njohur, e publikuar, ose të jetë një çështje e dokumentuar në regjistrat përkatës.

Konstatohet se as shumica dhe as DSIK-ja nuk kanë përmendur se cilat janë: baza ligjore, afati, rrethanat dhe informacionet, mbi bazën e të cilave është bërë rishikimi i raportit për kontrollin e figurës.

Nga sqarimet e dhëna dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit është vërejtur se ai është pajisur nga Ambasada e SHBA-ve në Tiranë më datë 12.07.2015 me vizë të tipit B1/B2, në pasaportën private, si dhe më datë 17.09.2013, po nga kjo ambasadë, njëkohësisht ai është pajisur edhe me vizë të tipit A1, e cila skadonte më datë 16.09.2018 – çka do të thotë se subjekti i rivlerësimit ka qenë i pajisur me dy viza, njëra private dhe tjetra për arsye pune, nga e njëjta konsullatë. Më datë 26.01.2017 rezulton se subjekti i rivlerësimit është thirrur në Konsullatën e SHBA-ve në Tiranë dhe, po në atë datë, ai është njoftuar për revokimin e vizës private B1/B2, ndërkohë ka rezultuar se ai ka vijuar të ketë pasur ende në fuqi vizën tjetër, të tipit A1, lëshuar për arsye pune.

Referuar nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës, pika 4, nëse subjekti rivlerësimit përpiqet të bëjë deklarime të pasakta ose të fshehtë kontakte me persona të krimin të organizuar, zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.

Nëse i referohemi Deklaratës mbi Kontrollin e Figurës, pjesa nr. 5, germa “g”: *“Gjatë 10 viteve të fundit a ju është refuzuar hyrja në ndonjë nga shtetet e BE/NATO-s ?”*, vërehet se subjekti i

rivlerësimit nuk ka deklaruar mbi revokimin e vizës së tipit A1 nga Ambasada e SHBA-ve në Tiranë, më datë 26.01.2017. Ky fakt është i vërtetë, por i pamjaftueshëm për të plotësuar elementet e përmendura në ligj dhe në Aneksin e Kushtetutës si i papërshtatshëm për komponentin e figurës. Kjo pasi, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se mosdeklarimi ka ardhur së pari për arsye të kohës në dispozicion dhe modaliteteve të dorëzimit të raportit dhe, së dyti, pasi ai dispononte një vizë tjetër, të tipit A1, të vlefshme në pasaportën e punës. Koha në dispozicion për të sqaruar vlefshmërinë e vizave dhe deklaruar refuzimin (nëpërmjet sqarimeve përkatëse) për hyrje në Shtetet e Bashkuara duket se ka qenë shumë e shkurtër dhe logjika e refuzimit nuk qëndronte.

Ky fakt nuk është shqyrtuar as nga ana e DSIK-së, as nga ana e shumicës, gjatë arritjes së përfundimit për papërshtatshmërinë e vazhdimit të ushtrimit të detyrës nga ana e subjektit të rivlerësimit, z. Artan Zeneli. Mbështetur në raportin e rishikuar të DSIK-së dhe hetimin e njëanshëm të kryer nga Komisioni, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të shpjeguar dhe provuar të kundërtën. Ai paraqiti shpjegimet e tij, duke i shoqëruar edhe me dokumentacionin përkatës dhe arsyet për të cilat ai nuk e kishte deklaruar këtë fakt. Por, nga ana e shumicës, ato nuk u morën në konsideratë, duke u qëndruar në mënyrë të njëanshme vetëm provave dhe argumenteve të marra nga Komisioni gjatë hetimit kryesisht.

Duke e konsideruar procesin e rivlerësimit një proces kushtetues që, megjithëse përfshin edhe kufizimin e të drejtave të subjekteve të rivlerësimit, duhet të kryhet në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, raporti për subjektin e rivlerësimit duhet të jetë konkret, sa më i qartë, mbështetur në të dhëna të sakta. Konkluzioni i arritur nga ana e shumicës, – sipas të cilit subjekti i rivlerësimit ka paraqitur të dhëna të pavërteta ose të pasakta, – është i pambështetur në ligj e në fakte. Në tilla rrethana duhet të vlerësohet nëse subjekti i rivlerësimit ka pasur qëllim të bëjë deklarime të pasakta ose të fshehtë kontaktet me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Nga të gjitha rrethanat e fakteve, rezulton se nuk kemi të bëjmë me kontakte dhe, aq më tepër, me kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Saktësia dhe fshehja janë veprime që kërkojnë qëllimin për t’iu shmangur kontakteve me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

Revokimi i vizave për disa kategori të caktuara funksionarësh publikë është në diskrecionin e autoriteteve të huaja dhe, duke përbërë një fakt të njohur botërisht e të njoftuar në media, ky shkak nuk përfshihet as në shkaqet që parashikojnë shkeljet disiplinore sipas ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Pra, refuzimi nuk përbën shkak, mosdeklarimi nuk ka qenë i qëllimshëm, për të fshehur një fakt, por i arsyetuar sa më sipër.

Shumica ka gabuar në konkluzionet e nxjerra, sepse: Së pari, DSIK-ja dhe shumica nuk kanë kryer hetim të plotë në rastin e rishikimit të raportit mbi papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit, z. Artan Zeneli, për shkak të mosdeklarimit të revokimit të vizës, për faktin se ka marrë në konsideratë të dhëna për revokimin e vetëm të njëjës vizë. Së dyti, subjekti i rivlerësimit kishte ende në fuqi edhe një vizë tjetër amerikane, të tipit A1, lëshuar për motive pune, çka do të thotë se atij nuk i është refuzuar hyrja, por thjesht i është ishte revokuar njëra nga vizat e lëshuara. Së treti, në letrën e Konsullatës merikane të datës 26 janar 2017 dhe atë të datës 18 qershor 2018, sqarohet se subjekti i rivlerësimit mund të aplikojë përsëri për vizë, çka tregon se atij nuk i është refuzuar hyrja, por thjesht i është anuluar viza. Së katërti, edhe sikur të konsiderohet revokimi i vizës private një refuzim hyrjeje, në momentin e dorëzimit të Deklaratës për Kontrollin e Figurës, subjekti i rivlerësimit kishte në fuqi vizën tjetër zyrtare amerikane, të tipit A1, prandaj mospërmendja e revokimit të njëjës vizë, kur në fakt subjekti kishte në fuqi edhe një vizë tjetër, nuk mund të konsiderohet as deklarim i pasaktë, as deklarim i pavërtetë.

Në të tilla rrethana, kam bindjen e bazuar në prova dhe ligj se subjekti i rivlerësimit, z. Artan Zeneli, nuk gjendet në asnjërin prej rasteve të parashikuara nga neni 38 i ligjit nr. 84/2016 dhe

ato të parashikuara nga neni Dh i Aneksit të Kushtetutës dhe, për rrjedhojë, nuk përmbushet asnjë kriter ligjor dhe kushtetues që do të përcaktonte papërshtatshmërinë e vazhdimit të detyrës, sipas konkluzioneve që ka arritur shumica dhe raporti i rishikuar i DSIK-së.

**II. Në lidhje me vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Artan Zeneli,** gjykoj se vlerësimi i saj nga ana e shumicës nuk është i saktë dhe në përputhje me ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Referuar ligjit të rivlerësimit, si dhe Aneksit të Kushtetutës, koncepti i “periudhës së rivlerësimit” edhe për komponentin e pasurisë *duhet të lidhet kryesisht* me periudhën e ushtrimit të funksionit të gjyqtarit apo prokurorit, ashtu sikurse edhe për dy komponentët e tjerë të vlerësimit, atë profesional dhe të figurës, të cilët ligji i lidh me periudhën e ushtrimit të detyrës. Nëse e lexojmë ligjin në tërësinë e tij, si dhe rekomandimet e Komisionit të Venecias lidhur me këtë proces, i tërë procesi i rivlerësimit ka pasur për synim çlirimin e sistemit të drejtësisë nga influenca të jashtme dhe korrupsioni. Korrupsion ky i ardhur për shkak të funksionit. Po ashtu, arsyeja tjetër lidhej me nivelin e pakënaqshëm të cilësisë së punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve. Komisioni i Venecias është shprehur se: “... është e mendimit se këto masa janë të nevojshme që Shqipëria të mbrohet nga korrupsioni, i cili nëse nuk trajtohet, mund të shkatërrojë tërësisht sistemin gjyqësor.” Korrupsioni në sistemin e drejtësisë përkthehet kryesisht në vënien e pasurive të paligjshme apo të pajustificuara të gjyqtarëve dhe prokurorëve, apo në bashkëpunimin e tyre me kontakte të papërshtatshme, kjo për shkak të funksionit.

Periudha e rivlerësimit, e cila duhet t’u nënshtrohet dispozitave kushtetuese dhe atyre ligjore të parashikuara nga Aneksi i Kushtetutës dhe ligji nr. 84/2016, është ajo gjatë ushtrimit të funksionit. Nga ana tjetër, deklarimi i pasurisë në kuptim të ligjit nuk kufizohet vetëm brenda kësaj periudhe, pasi subjekti duhet të deklarojë çdo pasuri të vënë, dhe mendoj se këtu ligji i është referuar logjikës për burimin e ligjshëm të pasurive të vëna gjatë periudhës së rivlerësimit, si dhe për të vlerësuar integritetin dhe pastërtinë e figurës së funksionarit që do të ushtrojë funksionin publik. Verifikimi i kësaj pasurie duhet t’u nënshtrohet rregullave të zakonshme të verifikimit dhe kontrollit të pasurisë të përcaktuara nga ILDKPKI-ja dhe ligji për kontrollin e pasurive të funksionarëve publikë (rregullave të kontrollit të pasurisë për deklarimin para fillimit të detyrës).

Z. Zeneli ka qenë gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë Krujë e më tej në atë të Tiranës deri në vitin 1999, kur ai u largua me dëshirën e tij për të ushtruar funksionin e avokatit. Ai e ushtroi këtë funksion nga viti 1999 deri në vitin 2009. Më pas, u rikthye në sistemin gjyqësor, duke ushtruar detyrën e funksionarit publik, atë të gjyqtarit.

Pasuria e z. Zeneli, e deklaruar në Formularin-Vetting, duhet t’i nënshtrohet një kontrolli të plotë, përfshi këtu edhe pasuritë e vendosura gjatë kohës që ai nuk ushtronte funksionin e gjyqtarit, për t’u siguruar se funksionari publik është një person me integritet dhe nëse e gjithë pasuria e tij është e ligjshme. Nuk mund të përjashtojmë nga kontrolli pasuritë e vendosura para fillimit të detyrës. Por, nga ana tjetër, rivlerësimi i subjektit duhet të fokusohet kryesisht te pasuritë e vëna gjatë ushtrimit të detyrës dhe se pasuritë e vendosura para detyrës duhet të analizohen rast pas rasti, për të parë nëse ka elemente të mjaftueshme për të sjellë si pasojë shkarkimin, si nga pikëpamja e provave të besueshme, ashtu edhe nga pikëpamja e proporcionalitetit dhe efektivitetit, apo gjetja e elementeve thelbësore verifikuese për ta lidhur vënien e asaj pasurie me qëllimin e ligjit të rivlerësimit.

Mbi pasuritë e subjektit të rivlerësimit, z. Artan Zeneli, gjykoj se:

**1. Në lidhje me pasurinë: Banesë, “\*\*\*” nr. \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, Tiranë, me sip. ndërtimore 260 m<sup>2</sup> dhe oborr 200 m<sup>2</sup>, të vendosur në parcelën 300 m<sup>2</sup>, shumica ka arritur në konkluzionin se nga subjekti i rivlerësimit, z. Artan Zeneli, ka mospërputhje lidhur me: a) pagesën për këtë pasuri.**

Nuk jam dakord me përfundimin e arritur nga shumica për arsye se kjo pasuri është vënë nga subjekti i rivlerësimit në periudhën kohore kur ai nuk kishte funksionin e gjyqtarit apo atë të prokurorit. Rivlerësimi kalimtar i subjekteve të parashikuara nga neni 179/b i Kushtetutës kërkon si kusht logjik dhe juridik pasjen e njërës prej funksioneve të parashikuara nga neni 179/b i Kushtetutës gjatë periudhës së vlerësimit të pasurisë. Përfundimi i arritur nga ana e shumicës është i pambështetur në fakt dhe ligj. Në vitin 2007, subjekti i rivlerësimit Artan Zeneli nuk ka pasur funksionin e gjyqtarit, por funksionin e avokatit privat dhe njëherazi të anëtarit të Këshillit Kombëtar të Radiotelevizionit Shqiptar (nga muaji tetor 2007). Fakti i shqyrtuar nga ana e shumicës është jashtë periudhës kur z. Artan Zeneli ka qenë në cilësinë e subjektit të rivlerësimit. Pasuria e sipërpërmendur është porositur me kontratën për ndërtim vile me shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k., më datë 04.06.2007.

Shumica ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Artan Zeneli, nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të blerë apartamentin me vlerë 196.738 euro, duke iu referuar pagesës së çmimit në mënyrë të menjëhershme, por subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se kësti i parë i çmimit, prej 46.000 eurosh, është paguar prej tij nga të ardhurat e fituara nga veprimtaria si avokat dhe të ardhurat e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit. Pjesa tjetër e detyrimit, prej 150.000 eurosh, e cila do të paguhej me kredi, është marrë përsipër nga ana e administratorit-ortak të shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., z. G. S, kundrejt kësaj shoqërie. Kur kjo shumë është disbursuar nga ana e bankës, i është paguar direkt në llogarinë e administratorit-ortakut të shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k. Ky fakt provohet me shkresën e administruar nga ana e shumicës, ku konfirmohet nga shoqëria “\*\*\*” sh.p.k., me shkresën kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 02.03.2018, e cila ka paraqitur pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit kontratën për ndërtim vile nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\*kol., datë 04.06.2007, përpara noterit E. H, duke konfirmuar se detyrimi kontraktor prej 196.738 eurosh është likuiduar nga subjekti i rivlerësimit, z. Artan Zeneli, si vijon: 1) kësti i parë, prej 46.738 eurosh, është paguar nga subjekti i rivlerësimit me nënshkrimin e kontratës për ndërtim vile; 2) kësti i dytë, prej 150.000 eurosh, është paguar nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet kredisë bankare më datë 04.02.2008; 3) marrëdhënia e sipërmarrjes është kaluar nga ana e administratorit të shoqërisë, nga llogaria personale e tij në llogarinë e shoqërisë dhe më tej, kalimi i kredisë është bërë në llogarinë personale të administratorit dhe ortakut të shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., z. G. S. Në këto rrethana, me lëvrimin e kredisë, shoqëria “\*\*\*” sh.p.k. ka marrë pjesën e mbetur të çmimit, ndërsa marrëdhënia e huas së subjektit të rivlerësimit ka vijuar me bankën “Raiffeisen”. Në kushtet kur z. Zeneli ishte një avokat privat dhe nuk kishte asnjë detyrim për deklarim, cila do të ishte arsyeja për marrjen e një kredie prej 150.000 eurosh për blerjen e një banese/vile dhe kalimin e kësaj shume tek administratori i përgjithshëm i shoqërisë ndërtimore, që kreu edhe kontratën e porosisë për ndërtimin e vilës, përveçse asaj të pagimit të çmimit të plotë të kësaj banese (likuidimin e vlerës së kontratës). Kontrata e sipërmarrjes dhe deklarimi i pasurisë përpara fillimit të detyrës i referohen marrëdhënies me shoqërinë sipërmarrëse, duke konfirmuar se çmimi u pagua në vitin 2007 ndaj shoqërisë, çfarë do të thotë se marrëdhënia midis subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë është përmbushur që në momentin e lidhjes së kontratës. Ky fakt përkon me deklarimin fillestar përpara detyrës së subjektit të rivlerësimit dhe faktin se kontrata noteriale e sipërmarrjes i referohet një situatë tjetër dhe nuk e përjashton vijimin e marrëdhënies juridike plotësisht të ligjshme dhe këtë mënyrë pagese me administratorin-ortak të shoqërisë. Po ashtu, nga ana e shumicës nuk është marrë parasysh fakti i vijimit të marrëdhënies mes ortakut të shoqërisë dhe subjektit të rivlerësimit, duke arritur në përfundimin e gabuar se pagesa e çmimit për këtë pasuri nuk është e lidhur me lëvrimin e kredisë bankare. Sipas kontratës së kredisë, lidhur me bankën “Raiffeisen”, datë 8 janar 2008, në nenin 6 të saj përcaktohen në mënyrë të qartë të dhënat e pronës për të cilën jepet kredia, duke provuar në mënyrë të qartë dhe me prova të besueshme lidhjen e kredisë për të njëjtën pasuri, e cila mbas regjistrimit në ZRPP do të bllokohet si garanci bankare. Kontrata bankare ka fuqinë e ligjit dhe konfirmon faktin e pretenduar nga ana e subjektit të rivlerësimit, ajo ka një datë më të hershme se Deklarata-Vetting e vitit 2017.

Nga të gjitha dokumentet dhe provat rezulton e qartë se, me lëvrimin e kredisë nga ana e bankës, marrëdhënia e detyrimit mes shoqërisë sipërmarrëse “\*\*\*” sh.p.k., me administrator z. G. S, dhe subjektit të rivlerësimit është e përfunduar, duke kaluar detyrimi i huas midis bankës “Raiffeisen” dhe subjektit të rivlerësimit, marrëdhënie kjo e cila ka vijuar dhe ky fakt është pasqyruar nga subjekti i rivlerësimit në deklarin periodik të vitit pasardhës për vitin 2008, duke konfirmuar vërtetësinë dhe saktësinë e Deklaratës-Vetting të vitit 2017.

Ndryshe nga sa ka konkluduar shumica, pasuria e sipërpërmendur është krijuar me të ardhura e përfituara nga kontrata e huas me bankën “Raiffeisen”, për kredi në shumën 150.000 euro, datë 08.01.2008, ndërsa pjesa tjetër me të ardhurat e fituara nga puna e subjektit të rivlerësimit si avokat dhe të ardhurat e personave të lidhur me të. Kjo pasuri është ndërtuar në bazë të kontratës për ndërtim vile, datë 04.06.2007, me sipërmarrës shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k.

Në të tilla rrethana faktike dhe juridike, konstatoj se deklarimi në Deklaratën-Vetting të vitit 2017 nga ana e subjektit të rivlerësimit për sa i përket burimit të krijimit, – që është: kredi nga “Raiffeisen Bank” në vlerën 150.000 euro, kurse pjesa tjetër nga të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të, – është i saktë dhe përputhet me dokumentet shkruesore dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit.

Sa i përket **b) deklarimit të sipërfaqes së oborrit të pasurisë së sipërpërmendur**, në rezultatet e hetimit paraprak është konstatuar mospërputhje për sipërfaqen e këtij apartamenti dhe deklarime kontradiktore në raport me sipërfaqen e këtij apartamenti.

Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar në mënyrë të besueshme dhe të mbështetur në prova ligjshmerinë e origjinës së kësaj pasurie. Nga të gjitha të dhënat e faktit ka rezultuar se ai nuk ka ndërmarrë hapa për të fshehur ose për të deklaruar në mënyrë të pasaktë këtë pasuri të tij. Sipërfaqja e deklaruar për këtë pasuri nuk është kontradiktore, ajo nuk ka ndryshuar, duke mbetur e njëjtë dhe u bazuar në të njëjtat dokumente justifikuese.

Për rrjedhojë, në konkluzionin e shumicës janë marrë në konsideratë dhe pranuar shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, i cili ka provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

**2. Në lidhje me pasurinë shtesë 3/12 e 35 m<sup>2</sup>, banesë, kati i parë i banesës dykatëshe dhe oborr përpara, në Rr. “\*\*\*” nr. \*\*\*, Tiranë, shumica ka arritur në gjetjen dhe konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar këtë pasuri në Deklaratën-Vetting.** Sipas ligjit nr. 84/2016, përcaktohet se objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmerisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij. Pasuria në fjalë rezulton se është krijuar me të ardhurat e përfituara prej pagave nga puna e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të. Kjo shtesë pasurie rezulton të jetë fituar në bazë të një kontrate shitblerjeje nga Bashkia Tiranë, në zbatim të ligjit për privatizimin e banesave. Nga ana e shumicës nuk është kundërshtuar as burimi i krijimit të kësaj shtese pasurie, as mungesa e të ardhurave të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie nga ana e subjektit të rivlerësimit. Në këto kushte, duhej të analizohej nëse kemi të bëjmë me mosdeklarim apo me fshehje të një pasurie. A ka qenë mosdeklarimi i qëllimshëm, për të fshehur këtë pasuri, të vënë në kohën kur subjekti i rivlerësimit ushtronte detyrën e avokatit dhe ajo ishte pasuri e vënë me të ardhura të ligjshme dhe plotësisht të justifikuar?

Që të kemi mosdeklarim të pasurisë apo fshehje të pasurisë është e nevojshme kryerja e veprimeve të tilla: si këmbimi i pasurisë, fshehja apo mbulimi i natyrës së vërtetë të burimit, vendosjes, zhvendosjes, pronësisë ose të drejtave të tjera pasurore, që do të çonin në moslidhjen dot të pasurisë me pronarin e vërtetë të saj, duke e vendosur atë në emër të një personi tjetër, të ndryshëm nga rrethi i personave për të cilët subjekti është i detyruar të deklarojë pasurinë. Në rastin konkret, subjekti i rivlerësimit, z. Artan Zeneli, nuk ka kryer asnjë prej veprimeve të mësipërme. Për arsye se mungon shkelja e dispozitës për mosdeklarimin apo fshehjen e pjesës

së pasurisë së shtuar, veprimi është kryer me akt noterial, nuk është vërejtur mungesë të ardhurash të ligjshme. Vërehet se mungon qëllimi për të mos deklaruar apo për ta fshehur këtë pasuri. Kjo, për shkak se nga ana e subjektit të rivlerësimit duket se nuk ka pasur vullnet për ta fshehur apo për të mos deklaruar këtë pasuri, e cila në fakt ka edhe një vlerë të papërfillshme. Në deklarin periodik për vitin 2017, shtimi i kësaj pasurie është deklaruar pranë ILDKPKI-së. Nga të gjitha rrethanat e faktit del se kemi të bëjmë me një harresë të paqëllimshme, që nuk ka sjellë fshehje të pasurisë. Edhe raporti i pjesës takuese të kësaj pasurie është i papërfillshëm. Shumica, në arritjen e përfundimeve të saj, ndonëse u referohet deklaratave periodike në mbështetje të konkluzioneve të saj, në këtë rast nuk e ka parë të arsyeshme t'i referohet edhe deklaratës periodike të vitit 2017 e cila, në bazë të nenit 33, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, ka vlerën e provës përpara Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Për sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar në mënyrë të besueshme dhe të mbështetur në prova ligjshmerinë e origjinës së kësaj pasurie. Nga të gjitha të dhënat e faktit ka rezultuar se ai nuk ka ndërmarrë hapa për të fshehur ose për të deklaruar në mënyrë të pasaktë këtë pasuri të tij, ndryshe nuk do të kishte kuptim deklarimi i kësaj pasurie në mënyrë të rregullt në deklarin periodik pasardhës. Po ashtu, subjekti ka treguar gatishmërinë e tij të menjëhershme për të dhënë sqarime rreth këtij fakti, kur është pyetur nga Komisioni, po ashtu edhe gjatë seancës dëgjimore. Ai ka qenë bashkëpunues, duke pranuar pasaktësinë dhe duke sqaruar se mungon qëllimi për fshehje apo mosdeklarim të kësaj pasurie. Si përfundim, për shkak se, së pari, mungon shkelja e këtij veprimi dhe, së dyti, mungon qëllimi për të mos deklaruar, nga vlerësimi në tërësi i rrethanave të faktit, shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, kam bindjen se kjo gjetje nuk është rilevante, prandaj nuk ndodhemi përpara rastit të zbatimit të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

**3. Në lidhje me pasurinë: Apartament me sip. 117 m<sup>2</sup>, Rr. “\*\*\*”, shk. \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë, me vlerë 41.000 USD, shumica ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, z. Artan Zeneli, ka bërë deklarime kontradiktore në raport me kontratën e shitblerjes për likuidimin e çmimit.**

Nuk jam dakord me përfundimin e arritur nga shumica për arsye se kjo pasuri është vënë nga subjekti i rivlerësimit, z. Artan Zeneli, në periudhën kohore kur ai nuk kishte funksionin e gjyqtarit apo atë të prokurorit dhe as të ndonjë subjekti tjetër që mbartte detyrimin për të deklaruar pasurinë. Rivlerësimi kalimtar i subjekteve, të parashikuara nga neni 179/b i Kushtetutës, kërkon si kusht logjik dhe juridik pasjen e njërit prej funksioneve të parashikuara nga neni 179/b i Kushtetutës gjatë periudhës së vlerësimit të pasurisë gjatë kohës së ushtrimit të funksionit, sipas nenit Ç, pika 4, të Aneksit të Kushtetutës. *Së pari*, fakti i shqyrtuar nga ana e shumicës është jashtë periudhës kur z. Artan Zeneli ka qenë në cilësinë e subjektit të rivlerësimit, pasi ai në vitin 1999 nuk ka qenë subjekt i deklarimit të pasurive. *Së dyti*, në vendimin e shumicës nuk është përcaktuar në mënyrë të sigurt nëse pagesa e çmimit të kësaj pasurie është bërë me këste apo është paguar menjëherë, nëse është bërë vetëm në vitin 1999 dhe mënyrën si është kryer pagesa midis administratorit dhe shoqërisë dhe midis administratorit dhe subjektit të rivlerësimit. Shumica ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Artan Zeneli, nuk ka pasur pasuri të mjaftueshme për të blerë apartamentin me vlerë 41.000 dollarë. Por, arritja e këtij përfundimi nuk ka marrë parasysh shpjegimin e dhënë nga subjektit i rivlerësimit, se pagesa është bërë me pjesë dhe se pjesën e mbetur të detyrimit për shlyerjen e apartamentit ndaj shoqërisë e ka marrë përsipër ta paguante administratori dhe ortaku i shoqërisë, z. A. Gj. Ky fakt mbështetet edhe në deklarin fillestar të vitit 2007, ku subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se, përveç banesës së prindërve, burimet e krijimit janë të ardhurat si avokat “që prej vitit 1999”. Periudha e kalimit të pasurisë është e vërtetë që përkon me vitin 1999, por asnjë prej dokumenteve dhe provave nuk përjashton vijimin e marrëdhënies së detyrimit ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe z. Gj dhe pagimin e detyrimit në mënyrë graduale dhe të ndarë në këste, sipas një periudhe deri në vitin 2004, kohë në të cilën z. Zeneli ishte avokat privat. *Së treti*, shumica në arsyetimin e saj u referohet si prova deklarimeve të

bëra pranë ILDKPKI-së, provave shkresore të administruara nga ana e ILDKPKI-së, si edhe provave shkresore të administruara në dosje nga institucionet publike dhe private. Të gjitha këto prova nuk provojnë faktin se pagesa është bërë e menjëhershme dhe e plotë në vitin 1999. Në deklaratën fillestare të vitit 2007, para marrjes së detyrës, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se pasurinë e ka fituar në vitin 1999 dhe ka deklaruar vlerën e çmimit përkundrejt shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k. Ky deklaram përputhet edhe me atë çka ishte e parashikuar në kontratën e blerjes, por asnjë provë e administruar nuk përjashton mënyrën e pagesës me këste dhe vazhdimin e marrëdhënies së detyrimit midis ortakut dhe administratorit të shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k. Është e vërtetë se subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar një kontratë noteriale, e cila edhe pse është akt autentik për sa i takon vërtetësisë së nënshkrimit të aktit nga dy subjektet, nuk i pengon ata si individë, që me veprime të mëtejshme të ndryshojnë apo të rregullojnë veprimtarinë e tyre private, sipas lirisë kontraktore që u njeh Kushtetuta dhe legjislacioni në fuqi. Pikërisht ky fakt është anashkaluar të hetohet dhe të shqyrtohet nga ana e shumicës, e cila duhet të merrte në konsideratë ushtrimin e lirisë kontraktore, duke mos harruar faktin se z. Artan Zeneli në këtë periudhë ka qenë një avokat privat që nuk ushtronte funksione publike dhe nuk mbartte detyrimin për të bërë deklarime të pasurisë. *Së katërti*, deklarata fillestare përpara fillimit të detyrës si anëtar i KKRTSH-së nuk është një deklaram periodik që të mund të provojë ndryshimet e pasurisë në formën pakësimit apo shtimit të pasurisë brenda një viti të caktuar kalendarik dhe të provojë kryerjen e pagesës në mënyrë të menjëhershme dhe të vetme brenda vitit 1999. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se shoqëria “\*\*\*” sh.p.k. e ka marrë çmim të plotë, pasi diferenca prej 33.000 USD është paguar nga z. Gj te shoqëria (ku 8000 USD janë paguar nga subjekti i rivlerësimit në çastin e lidhjes së kontratës, si këst i parë, ndërsa dhe diferenca ndër vite në këste është paguar përkatësisht 4000 USD në vitin 2000; 4000 USD në vitin 2001, 4000 USD në vitin 2002 dhe 21.000 USD në vitin 2004). Në të tilla rrethana shumica, me qëllim kryerjen e një hetimi të thellë dhe të gjithanshëm, pas shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga z. Zeneli, duhet të kishte vijuar hetimin, duke pyetur dhe ballafaquar me provat edhe z. A. Gj, për të verifikuar në këtë mënyrë pretendimet e subjektit të rivlerësimit, të cilit i ishte ngarkuar edhe barra e provës për të provuar të kundërtën. *Së pesti*, kalimi i një periudhe të gjatë kohore 15-vjeçare e bën thuajse të pamundur plotësimin e detyrimit mbi kalimin e barrës së provës për ruajtjen e dokumenteve provuese për një periudhë kaq të gjatë kohore.

Konkluzioni i shumicës mbi pagimin e çmimit në mënyrë të menjëhershme dhe të plotë në vitin 1999 mbështetet vetëm në kontratën e shitblerjes dhe deklarimin në Deklaratën-Vetting të subjektit të rivlerësimit. Kam bindjen se ky konkluzion (pra mënyra e likuidimit të çmimit) i arritur nga shumica nuk mund të provohet nga Deklarata-Vetting, e cila nuk përbën objektin që provon, por objektin që synohet të provohet. Deklarimi fillestar i pasurisë i vitit 2007 i subjektit të rivlerësimit, z. Artan Zeneli, nuk ka pasur për objekt as deklarimin e mënyrës së pagesës dhe as kohën e saktë të pagimit të çmimit, por vetëm deklarimin e çmimit të kësaj pasurie (z. Zeneli nuk ka qenë as gjyqtar). Deklarimi mbi kohën e kryerjes së pagimit të çmimit dhe mënyrës, janë të dhëna të cilat për herë të parë janë kërkuar në Deklaratën-Vetting të vitit 2017. Ky fakt provohet edhe nga pika 2 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, ku parashikohet shprehimisht se: “2. *Subjekti i rivlerësimit dorëzon një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë në përputhje me ligjin*”. Deklarimi fillestar përpara fillimit të detyrës, i vitit 2007, për pasuri të fituara në të shkuarën (në vitin 1999), edhe nëse mund të merret me fuqinë e provës, mund të provojë vetëm faktin e vlerës së pasurisë (çmimit), por jo kohën dhe mënyrën e pagesës së këtij çmimi. Në të tilla rrethana, koha reale e pagimit të çmimit dhe mënyra e pagesës së tij e ndarë në këste me afate ose jo, nuk mund të provohet nga deklarimi fillestar i pasurisë në vitin 2007 dhe njëherazi nuk mund të mbështesë përfundimin se fitimi i kësaj pasurie është bërë brenda vitit 1999. Po kështu, edhe kontrata noteriale e shitjes nuk është përcaktuese për të provuar kohën dhe mënyrën e pagimit të çmimit, për sa kohë që marrëdhënia juridike ka vijuar me palën tjetër dhe nuk kërkohej forma me shkrim dhe kontrata e shitjes është kontratë konsensuale (pëlqimi), ku nuk kërkohej pagimi kontekstual me qëllim mbylljen e saj. Për më



tepër, në konsideratë duhej mbajtur dhe fakti se administratori dhe ortaku i shoqërisë e ka konfirmuar këtë marrëdhënie.

Arritja në konkluzionin se pasuria nuk justifikohet me të ardhura të fituara nga pagat e subjektit të rivlerësimit dhe e personave të lidhur me të nga ana e shumicës mbështetet në faktin se pagesa e çmimit për këtë pasuri është bërë vetëm dhe në mënyrë të menjëhershme brenda vitit 1999. Por ky fakt, tepër i rëndësishëm, nuk rezulton të jetë analizuar dhe madje është marrë i mirëqenë nga ana e shumicës, e cila referon se: “*Në deklaratën para marrjes së detyrës (2007) subjekti i rivlerësimit, ka deklaruar se e ka paguar tërësisht këtë pasuri*”, ndërsa subjekti i rivlerësimit, në faqen 3/2 të deklaramit fillestar të vitit 2007, ka deklaruar se: “*Në lidhje me burimet, përveç privatizimit të banesës, të gjitha pasuritë e mia janë krijuar nga të ardhurat si avokat që prej vitit 1999*”. Sikundër vërehet nga kjo deklaratë, përjashtohet fakti që pasuria e sipërcituar të jetë paguar menjëherë dhe vetëm në vitin 1999, siç ka pretenduar shumica në gjetjen e saj.

Në analizë të deklaramit fillestar, përpara fillimit të detyrës në vitin 2007, rezulton se nga ana e subjektit është dhënë me shifra deklarimi i vlerës së kësaj pasurie, por jo deklarimi se “çmimi është shlyer tërësisht në vitin 1999”. Ky pretendim bazohet vetëm në kontratën e blerjes noteriale midis palëve, megjithatë ky deklarim i referohet shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., pra jo marrëdhënies me administratorin e kësaj shoqërie dhe subjektin e rivlerësimit, marrëdhënie e cila ka vijuar deri në vitin 2004 dhe ky fakt nuk ishte objekt i asaj kontrate. Pretendimi i shumicës se kjo pasuri është shlyer në mënyrë të menjëhershme në vitin 1999 është i pambështetur në fakt dhe nuk mund të provohet nga deklarimi fillestar përpara fillimit të detyrës së subjektit të rivlerësimit, për sa kohë që deklarimi fillestar përpara fillimit të detyrës i vitit 2007 provon vetëm vlerën e çmimit, por jo mënyrën dhe kohën e pagesës. Ndërsa kontrata noteriale e blerjes i referohet një pale tjetër dhe nuk e përjashton këtë mënyrë pagese.

Shumica ka anashkaluar, pa analizuar dhe pa provuar faktin nëse çmimi për blerjen e kësaj pasurie është paguar në mënyrë të menjëhershme ndaj administratorit dhe ortakut të shoqërisë. Ajo i ka kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit, por nuk ka analizuar shpjegimet e dhëna prej tij, si dhe provat e paraqitura. Shumica i ka konsideruar ato shpjegime të reja që vijnë vetëm pasi subjektit i ka kaluar barra e provës, por vetë neni 52 i ligjit nr. 84/2016 parashikon paraqitjen e provave dhe dhënien e shpjegimeve, të cilat të provojnë të kundërtën e rezultateve të hetimit dhe që duhet të vlerësohen me objektivitet dhe në mënyrë proporcionale.

Për sa më sipër, mbështetur në faktet e lartpërmendura, vlerësoj se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe provat shkresore shpjegojnë dhe provojnë në mënyrë të qartë dhe bindëse faktin se krijimi i pasurisë së mësipërme është bërë mbi bazën e të ardhurave të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të dhe se pagesa për këtë pasuri është bërë në mënyrë të pjesshme dhe jo të menjëhershme, duke filluar që nga viti 1999 me 8.000 USD, në vitin 2000 me 4.000 USD; në vitin 2001 me 4.000 USD, në vitin 2002 me 4.000 USD dhe në vitin 2004 me 21.000 USD. Deklarimi i subjektit të rivlerësimit i vitit 2007 thekson se pasuria nuk është paguar në vitin 1999, por duke filluar “që prej vitit 1999”. I njëjti deklarim është bërë edhe në Deklaratën-Vetting të vitit 2017, ku deklarohen afatet e shlyerjes së pagesës në mënyrë graduale dhe jo të menjëhershme, marrëdhënia sipas kontratës noteriale i referohet një marrëdhënieje tjetër të zëvendësuar. Nga të gjitha këto, rrjedh se përputhet deklarimi i subjektit të rivlerësimit me kohën dhe mënyrën e kryerjes së pagesave deri në vitin 2004. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar në mënyrë bindëse kohën dhe mënyrën e kryerjes së pagesave dhe burimin e të ardhurave të tij nga puna si avokat dhe të ardhurat e personave të lidhur me të, marrëdhënien me administratorin dhe ortakun e shoqërisë, për rrjedhojë nuk kemi të bëjmë me asnjërin prej rasteve të parashikuara nga neni 32 dhe neni 33 i ligjit nr. 84/2016, si dhe nuk ndodhemi në rastin e nenit 61, pika 3, apo pika 1 e ligjit nr. 84/2016, sepse nuk paraqitet as deklarim i pamjaftueshëm, për faktin se pasuria në fjalë është identifikuar drejt.

**4. Në lidhje me pasurinë: Apartament banimi me sip. 212.66 m<sup>2</sup>, ndodhur në Tiranë, Rr. “\*\*\*\*” pall. “\*\*\*\*”, kati \*\*\*\*, në vlerën 100.000 USD, shumica ka arritur në konkluzionin se nga subjekti i rivlerësimit, z. Artan Zeneli, ka mospërputhje deklarimesh për faktin se: a) pasuria apartament është e ndarë në dy njësi të tjera. Ky përfundim i rezultateve të hetimit është i pambështetur në fakt dhe ligj, pasi nga të gjitha rrethanat e faktit del se për këtë pasuri sipërfaqja totale apartamentit është e njëjta dhe nuk ka pasur mospërputhje deklarimesh, as fshehje pasurie, as deklarim të rremë.**

Për rrjedhojë, në konkluzionin e shumicës janë marrë në konsideratë dhe pranuar shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, i cili ka provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

Shumica ka arritur në konkluzionin se nga subjekti i rivlerësimit, z. Artan Zeneli, ka mospërputhje deklarimesh për faktin se: **b) ka mospërputhje për mënyrën e pagesës dhe nuk justifikohet nga të ardhurat që subjekti i rivlerësimit ka pasur në atë periudhë.** Nuk jam dakord me përfundimin e arritur nga shumica, për arsye se kjo pasuri është vënë nga subjekti i rivlerësimit, z. Artan Zeneli, në periudhën kohore kur ai nuk kishte funksionin e gjyqtarit apo atë të prokurorit apo të ndonjë subjekti tjetër që mbartte detyrimin për të deklaruar pasurinë. Rivlerësimi kalimtar i subjekteve, të parashikuara nga neni 179/b i Kushtetutës, kërkon si kusht logjik dhe juridik pasjen e njërit prej funksioneve të parashikuara nga neni 179/b i Kushtetutës gjatë periudhës së vlerësimit të pasurisë. Ky përfundim i arritur nga ana e shumicës është i pambështetur në fakt dhe ligj. Në vitin 2002, subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë subjekt i deklarimit të pasurive, ai ka qenë avokat privat. *Së pari*, fakti i shqyrtuar nga ana e shumicës është jashtë periudhës kur z. Artan Zeneli ka qenë në cilësinë e subjektit të rivlerësimit. *Së dyti*, në vendimin e shumicës nuk është përcaktuar në mënyrë të sigurt dhe nuk është arsyetuar nëse pagesa e bërë me këste është paguar sipas mënyrës dhe ndarjes së pretenduar nga shumica, duke mos hetuar dhe marrë parasysh të gjithë zhvillimin e marrëdhënies juridiko-civile dhe modalitetet e pagesave të kësteve sipas një marrëveshjeje të rënë dakord prej të gjitha palëve.

Shumica ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Artan Zeneli, nuk ka pasur pasuri monetare të mjaftueshme për të blerë apartamentin me vlerë 100.000 dollarë. Por, arritja e këtij përfundimi nuk ka marrë parasysh gjithë provat dhe shpjegimin e dhënë nga subjekti i rivlerësimit se koha dhe ndarja në këste e pagimit të çmimit të kësaj pasurie ka pësuar ndryshime. Në bazë të kontratës së sipërmarrjes, datë 15.11.2002, midis sipërmarrësit shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe porositësit Artan Zeneli është porositur ndërtimi i një apartamenti me sip. 212.66 m<sup>2</sup>, me çmim prej 100.000 USD. Shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., si palë sipërmarrëse në vitin 2005, e ka ndarë aktivitetin e saj me ortakët në disa biznese dhe përfundimi i ndërtimit, ku bënte pjesë kjo njësi pasurie banimi prej dy apartamentesh, i ka kaluar sipërmarrësit, z. P. F. Në aktmarrëveshjen nr. \*\*\*\*, datë 19.04.2005, për kalimin e kredive, marrëdhënieve financiare dhe atyre pasurore me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., parashikohej kalimi i të gjitha të drejtave dhe detyrimeve nga data 14.04.2005 te z. P. F. Në bazë të kësaj aktmarrëveshjeje, në vazhdim të kontratës së sipërmarrjes për pasurinë e mësipërme, lidhur në nëntor të vitit 2002, më datë 09.06.2005 midis sipërmarrësit P. F dhe subjektit të rivlerësimit është lidhur një aneks-marrëveshje për ndryshimin e ndarjes së pagesave dhe afatet e pagimit të kësteve. Në bazë të këtij aneksi të kontratës së sipërmarrjes, nënshkruar më datë 09.06.2006, është rënë dakord për pagimin e kësteve të mëparshme te shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k: nga viti 2002, në të cilin rezulton se porositësi Artan Zeneli kishte paguar 5.000 dollarë, në vitin 2004, porositësi Artan Zeneli kishte paguar këstin e dytë prej 47.000 dollarësh, në vitin 2005 porositësi Artan Zeneli kishte paguar këstin e tretë prej 38.000 dollarësh; si dhe në vitin në vitin 2006, porositësi Artan Zeneli kishte paguar këstin e katërt dhe të fundit prej 10.000 dollarësh te sipërmarrësi, z. P. F.

Konkluzioni i shumicës mbi pagimin e çmimit sipas kontratës së sipërmarrjes së datës 15.11.2002: *“Pagesa do të bëhet sipas kësteve: Kësti i parë, 52 mijë USD, në datën e nënshkrimit të kontratës. Kësti i dytë, 25 mijë USD, me para në dorë brenda datës 31.05.2003.*

*Kësti i tretë \_\_\_ (nuk parashikohet asgjë). Kësti i fundit do të paguhet me para në dorë në shumën 23 mijë USD brenda datës 31.01.2004”, nuk është i plotë dhe nuk i është nënshtruar një hetimi dhe një shqyrtimi të gjithanshëm. Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën fillestare përpara fillimit të detyrës deklaroi se e ka paguar duke filluar **që nga viti 1999**, pra jo në mënyrë të menjëhershme, – megjithatë deklarimi fillestar i pasurisë i vitit 2007 i subjektit të rivlerësimit, z. Artan Zeneli, nuk ka pasur për objekt as deklarimin e mënyrës së pagesës dhe as kohën e saktë të pagimit të çmimit, por vetëm deklarimin e çmimit të kësaj pasurie. Të gjitha veprimet për këtë pasuri janë deklaruar në vitin 2007, kur pasuria dhe çdo veprim ka qenë kryer më parë dhe çdo pasojë ka mbaruar. Deklarimi i kohës së kryerjes së pagimit të çmimit dhe mënyrës janë të dhëna, të cilat për herë të parë janë kërkuar në Deklaratën-Vetting të vitit 2017. Ky fakt provohet edhe nga pika 2 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, ku parashikohet shprehimisht se: “2. Subjekti i rivlerësimit dorëzon një deklaratë të re dhe **të detajuar të pasurisë në përputhje me ligjin**”.*

Deklarimi fillestar përpara fillimit të detyrës, i vitit 2007, për pasuri të fituara në të shkuarën (në vitin 2002), edhe nëse mund të merret me fuqinë e provës, mund të provojë vetëm faktin e vlerës së pasurisë (çmimit), por jo kohën dhe mënyrën e pagesës së këtij çmimi. Në të tilla rrethana, koha reale e pagimit të çmimit dhe mënyra e tij me afate të ndara në këste apo jo nuk mund të provohet nga deklarimi fillestar i vitit 2007. Në rastin konkret, krahas parashikimit të mënyrës së çmimit me këste, ka pasur një parashikim kontraktor të mëpasshëm që ka ndryshuar mënyrën dhe afatet e pagimit të kësteve sipas aneksit të marrëveshjes noteriale të datës 09.06.2005 mes palëve. Në këto rrethana, përfundimi i arritur nga ana e shumicës, sipas së cilit të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe të personave lidhur me të nuk justifikojnë blerjen e kësaj pasurie, ka anashkaluar, pa analizuar dhe pa provuar faktin nëse parashikimi kontraktor i vitit 2002 ka pësuar ose jo ndryshime të mëpasshme. Deklarimi i subjektit të rivlerësimit në vitin 2007 thekson se pasuria është paguar jo në mënyrë të menjëhershme. I njëjti deklarim është bërë edhe në Deklaratën-Vetting të vitit 2017, ku deklarohen afatet e shlyerjes së pagesës në mënyrë graduale dhe jo të menjëhershme. Nga analiza e kontratës së sipërmarrjes rezultoi se ka qenë ndarja e çmimit në këste, si dhe afatet për pagimin e tij. Nga mënyra e hartimit të kontratës, jo vetëm që palët nuk kanë përjashtuar mundësinë e ndryshimit të ndarjes në këste, por edhe vetë rrethanat e faktit e konfirmojnë një mundësi të tillë, mundësi e cila është ushtruar nga ana e subjektit të rivlerësimit. Është e vërtetë se subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar një kontratë noteriale me përcaktime të ndryshme, e cila edhe pse është akt autentik për sa i takon vërtetësisë së nënshkrimit të aktit nga dy subjektet, nuk i pengon ata si individë që, me veprime të mëtejshme të ndryshojnë apo të rregullojnë veprimtarinë e tyre private, sipas lirisë kontraktore që u njeh Kushtetuta dhe legjislacioni në fuqi, sipas një kontrate tjetër, po noteriale dhe autentike, me përcaktime të tjera që ka pasur forcën e ligjit. Pikërisht ky fakt është anashkaluar të hetohet dhe të shqyrtohet nga ana e shumicës, e cila nuk ka marrë në konsideratë ushtrimin e lirisë kontraktore, duke mos arsyetuar lidhur me këtë çështje, si dhe duke e ngarkuar të drejtën për ndryshimin e marrëdhënies fillestare me dyshime kundër subjektit të rivlerësimit, për shkak të ushtrimit të kësaj të drejte, e cila në fakt rezultoi të jetë e mbështetur në fakte dhe në ligj.

Për sa më sipër, mbështetur në faktet e përmendura, vlerësoj se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe provat shkresore shpjegojnë dhe provojnë në mënyrë të qartë dhe bindëse faktin se krijimi i pasurisë së mësipërme është bërë mbi bazën e të ardhurave të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të dhe se pagesa për këtë pasuri është bërë në mënyrë të pjesshme dhe jo të menjëhershme, sipas vullnetit të palëve, që nga viti 2002, 2004, 2005 dhe 2006, duke paguar në vitin 2002 (5.000 USD), në vitin 2004 (47.000 USD), në vitin 2005 (38.000 USD) dhe në vitin 2006 (10.000 USD).

Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar në mënyrë bindëse kohën dhe mënyrën e kryerjes së pagesave dhe burimin e të ardhurave nga puna si avokat dhe të ardhurat e personave të lidhur me të, ai ka shpjeguar në mënyrë të besueshme dhe të mbështetur në prova ligjshmerinë e

originës së kësaj pasurie. Nga të gjitha të dhënat e faktit ka rezultuar se ai nuk ka ndërmarrë hapa për të fshehur ose për të deklaruar në mënyrë të pasaktë këtë pasuri të tij, apo deklarim të pamjaftueshëm, kur pasuria në fjalë është identifikuar drejt. Për rrjedhojë, nuk kemi të bëjmë me asnjërin prej rasteve të parashikuara nga neni 32 dhe neni 33 i ligjit nr. 84/2016 dhe në rastin e nenit 61, pika 3, apo pika 1, e ligjit nr. 84/2016.

**5. Në lidhje me pasurinë: Apartament me sip. 74 m<sup>2</sup> në \*\*\*, Kavajë, kompleksi “\*\*\*”, e paregjistruar në ZRPP. Shuma është 45.500 euro.** Nga ana e shumicës në rezultatet e hetimit paraprak është konstatuar **mospërputhje sa i përket: sipërfaqes së këtij apartamenti dhe deklarime kontradiktore në raport me sipërfaqen e këtij apartamenti.** Pasuria e sipërpërmendur është krijuar me të ardhurat e përfituara nga kontrata e huas prej bankës “Emporiki” nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 24 gusht 2006, për kredi në shumën 40.000 euro, dhe pjesa tjetër nga të ardhurat nga puna si avokat e subjektit të rivlerësimit dhe të ardhurat e personave të lidhur me të. Kjo pasuri është ndërtuar në bazë të kontratës për ndërtim apartamenti, datë 28.06.2006, me sipërmarrës shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k, në vlerën 45.500 euro. *Së pari*, fakti i shqyrtuar nga ana e shumicës është jashtë periudhës kur z. Artan Zeneli ka qenë në cilësinë e subjektit të rivlerësimit. Në vitin 2006, subjekti i rivlerësimit, z. Artan Zeneli, nuk ka qenë subjekt i deklarimit të pasurive. *Së dyti*, nga analiza e dokumentacionit dhe e deklarimit fillestar përpara fillimit të detyrës, të vitit 2007, provohet në mënyrë të sigurt se kemi të bëjmë me të njëjtën sipërfaqe të pasurisë së deklaruar në vitin 2007 dhe të njëjtën sipërfaqe të pasurisë së deklaruar në Deklaratën-Vetting në vitin 2017. Në bazë të nenit 1 të kontratës për ndërtim apartamenti, datë 28.06.2006, me sipërmarrës shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k., rezulton se sipërfaqja e kontratës është përcaktuar shprehimisht në nenin 1, si vijon: “*Sipërmarrësi merr përsipër të ndërtojë për z. Artan Zeneli apartamentin \*\*\*, në vilën nr. \*\*\*, kati i tretë, parcela \*\*\*, me sipërfaqe apartamenti, sipas gentplanit bashkëngjitur, e përbërë nga 1 dhomë ndenjeje, 1 kënd gatimi, 2 dhoma gjumi, 1 banjë, 1 ballkon dhe tarraca me sipërfaqe 74 m<sup>2</sup>, sipas planimetrisë bashkëngjitur, si shtojcë A*”. Sipas planimetrisë së bashkëlidhur kontratës së sipërmarrjes, rezultojnë rreth 90 m<sup>2</sup> sipërfaqe banimi, përfshirë edhe sipërfaqet funksionale, siç janë: shkallët dhe ballkoni. Ndërsa në Deklaratën-Vetting, përshkrimi i kësaj pasurie i referohet kontratës së sipërmarrjes, e cila referon në të njëjtën sipërfaqe të kësaj pasurie. Në të dyja deklarimet planimetria është e njëjtë, kontrata e sipërmarrjes është e njëjtë dhe çmimi për këtë pasuri nuk ka ndryshuar. Zbatimi i ligjit për regjistrimin e pasurive të paluajtshme lidhur me regjistrimin e sipërfaqeve funksionale dhe atyre të përbashkëta, si ballkonet dhe tarraca, ka pasur praktika të ndryshme, të cilat herë shënohen në certifikatën e pronësisë, herë nuk shënohen në të, edhe pse ato ekzistojnë të pasqyruara në planimetri. Kjo pasuri ende nuk figuron të jetë e regjistruar në regjistrat e ZRPP-së përkatëse. *Së treti*, shumica nuk ka arsyetuar në lidhje zbatimin e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, se ku ka konsistuar “**deklarimi kontradiktor në lidhje me sipërfaqen**”, kur në fakt, është provuar pasja e të ardhurave më se të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie nga subjekti i vlerësimit dhe personat e lidhur të tij, sipas pikës 5, germa “b”, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016; po ashtu nuk arsyetohet as mungesa e veprimeve objektive të fshehjes dhe qëllimit për të fshehur, që kërkohet sipas pikës 5, germa “c”, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016; si edhe nuk argumentohet rrethana e deklarimit të rremë, sipas pikës 5, germa “ç”, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, e cila në rastin konkret mungon; shumica nuk shpjegon rreth ndonjë rrethanë që ka të bëjë me saktësinë e deklarimit të kësaj pasurie për të ndikuar në saktësinë tërësore të deklarimit sipas pikës 5, germa “a”, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

Nga të gjitha rrethanat e faktit del se për këtë pasuri sipërfaqja totale e apartamentit është e njëjta dhe nuk ka pasur mospërputhje deklarimesh, as fshehje pasurie, as deklarim të rremë. Asnjë prej provave nga ana e shumicës nuk ka arritur të provojë deklarime kontradiktore në lidhje me këtë pasuri.

Po ashtu, subjekti ka treguar gatishmërinë e tij të menjëhershme për të dhënë sqarime rreth këtij fakti, kur është pyetur nga Komisioni dhe gjatë seancës dëgjimore. Ai ka qenë

bashkëpunues, duke sqaruar arsyet e deklarimeve të tij lidhur me këtë pasuri dhe se mungon qëllimi për deklarime kontradiktore, por se deklarimet janë mbështetur mbi dokumentet që ai dispononte për këtë pronë (kontratë sipërmarrjeje +planimetri).

Si përfundim, për shkak se sipërfaqja për këtë pasuri nuk ka ndryshuar, duke mbetur e njëjtë dhe e bazuar në të njëjtat dokumente justifikuese dhe nga vlerësimi në tërësi i rrethanave të faktit, shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, kam bindjen se kjo gjetje nuk është rilevante, prandaj nuk ndodhemi përpara rastit të zbatimit të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

**III. Në lidhje me mospërfshirjen e rezultateve të hetimit administrativ për kriterin profesional të subjektit të rivlerësimit, z. Artan Zeneli,** nuk jam dakord me shumicën dhe me vendimin e ndërmjetëm të marrë prej saj, kur ka vendosur mospranimin e kërkesës. Realizimi i një procesi rivlerësimi *ex officio* për subjektin e rivlerësimit, z. Artan Zeneli, u mbështet në dy kritere, atë të pasurisë dhe atë të figurës, për të cilin Komisioni zhvilloi hetimin e tij kryesisht për rreth 7 muaj, kohë kjo më se e mjaftueshme për të përfunduar edhe hetimin e komponentit të tretë, atë të vlerësimit profesional. Vlerësimi profesional për subjektet e rivlerësimit bazohet kryesisht në shqyrtimin e 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe 5 dokumente të tjera ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi rastësor dhe objektiv. Ai bëhet mbështetur në raportin e hollësishëm të paraqitur nga organi kompetent (në rastin konkret Inspektorati i KLD-së), si dhe kriteret e vlerësimit të bazuara në ligjin nr. 96/2016. Mospërfshirja vetëm e këtij komponenti, *pa shkaqe të përligjura*, bie ndesh me parimin e paanësisë, duke e shndërruar procesin e rivlerësimit paragjykes.

Interpretimi i shumicës në rastin konkret, kur ka rrëzuar kërkesën e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore për përfshirjen në rivlerësim edhe të komponentit të tretë, duke vendosur të realizojë procesin e rivlerësimit mbi bazën e vetëm dy kritereve, atë të pasurisë dhe të figurës, bie ndesh me parimin e procesit të rregullt ligjor, pasi i krijon subjektit të rivlerësimit vonesa dhe zvarritje të procesit, në rast të një vendimi të ndryshëm nga shkallët më të larta të gjykimit, si dhe nuk lejon një vendimmarrje objektive dhe proporcionale nga anëtarët e trupit gjykues.

Në vlerësimin tim, realizimi i procesit të rivlerësimit, i pabazuar në të tria kriteret, duhet të vijë vetëm për shkaqe të përligjura dhe kur elementet e evidentuara të shkeljeve në njërin prej komponentëve janë të tillë që të përligjin plotësisht përcaktimet e neneve D, DH, apo E të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Në të kundërt, procesi do të ishte paragjykes dhe nuk respekton parimin e paanshmërisë në gjykim, të proporcionalitetit dhe objektivitetit në vendimmarrje dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor, parime këto të parashikuara shprehimisht nga pika 2 e nenit 179/b të Kushtetutës dhe pika 5 e nenit 4 të ligjit nr. 84/2016. Sipas germës “b” të pikës 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, shumica kishte detyrimin që të ndërmerre të gjitha procedurat për të garantuar provat e nevojshme për procesin e vendimmarrjes së trupit gjykues për të gjithë komponentët e rivlerësimit, përfshirë këtu edhe kriterin aftësive profesionale, për të cilin trupi gjykues ka hetuar, por që nuk ka arsyetuar përse nuk ka vendosur ta bëjë pjesë të rezultateve të hetimit administrativ, duke refuzuar përfshirjen e saj pas kërkesës së vet subjektit të rivlerësimit, me qëllim legjitimitetin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit për të kërkuar konfirmim në detyrë, mbështetur në provat dhe shpjegimet e paraqitura prej tij.

Për sa më lart, mbaj qëndrimin se kërkesa për përfshirjen e komponentit mbi aftësinë profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Artan Zeneli, duhet të ishte pranuar nga ana e shumicës.

Për të gjitha argumentet e shpjeguar më sipër, shpreh bindjen e bazuar në prova se subjekti i rivlerësimit, z. Artan Zeneli, nuk ndodhet në asnjë nga rastet e parashikuara nga neni 61 i ligjit nr. 84/2016, titulluar “Shkarkimi nga detyra”, pasi nuk u evidentua lidhja e shkeljeve të konstatuara me pasojën e parashikuar shprehimisht nga dispozita në fjalë. Nuk u provua pasja e pasurive më të mëdha sesa ato të justifikuar ligjërisht. Niveli i konstatimeve në lidhje me pasuritë, vlerësimin e figurës, marrë në tërësinë e tyre, nuk plotësojnë kriteret dhe shkaqet

që përligjin marrjen e masës disiplinore ekstreme të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit, prandaj duhej të gjente zbatim neni 59/1 i ligjit nr. 84/2016.

Dispozitat e parashikuara nga neni 61 i ligjit nr. 84/2016 zbërthejnë përcaktimet kushtetuese të parashikuara në nenin Ë të Aneksit të Kushtetutës, *prandaj arsyetimi në lidhje me këto dispozita përbën jo vetëm një detyrim ligjor, por edhe një detyrim kushtetues*, të parashikuar shprehimisht nga pika 1 e nenit Ë të Aneksit të Kushtetutës.

Në këto rrethana, nga provat e shqyrtuara dhe nga deklaratimet e bëra në seancën dëgjimore, krijoj bindjen se subjekti i rivlerësimit, z. Artan Zeneli, ka krijuar një nivel të besueshëm për vlerësimin e pasurisë, ka krijuar një nivel të besueshëm për vlerësimin e figurës. Për këtë arsye, në pajtim me parimin e proporcionalitetit dhe parimin e gjykimit të drejtë, konstatoj se duhet të zbatohet neni 59, pika 1, i ligjit nr. 84/2016, duke u rivlerësuar të gjitha kriteret e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Artan Zeneli. Në vlerësim të të gjithë përbërësve të vlerësimit, krijoj bindjen se shumica nuk duhet të kishte disponuar shkarkimin nga detyra të këtij subjekti, por duhej të kish vazhduar procedurën edhe me përfshirjen e komponentit të tretë të rivlerësimit dhe, më tej, trupi gjykues të shprehej për vlerësimin përfundimtar të subjektit të rivlerësimit.

**Anëtare**

**Valbona SANXHAKTARI**